



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr 119/2 Prot

Tiranë më 01/02/2023

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015; Rregullores së Brendshme të Institucionit; Organikës dhe Strukturës së Institucionit miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 shpall 1 (një) vend vakant në Drejtorinë e Operas dhe Filarmonisë përkatësisht tek Sektori i Orkestrës si më poshtë vijon:

❖ Spalë Sektori Orkestre instrumenti “Korno”;

Për ti dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për ti krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve TKOB nxjerrë njoftimin e saj 30 (tridhjetë) ditë përpara.

Audicioni për pozicionin e punës Spalë Sektori Orkestra instrumenti “Korno” do të mbahet në datën 13/03/2023 ora 11:00 në hollin koncertor Kati II, brenda Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor.

Të gjithë ata kandidatë të interesuar për pjesëmarrje për vendin vakant, duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Institucionit të TKOBAP-së deri në datën 06/03/2023 ora 14:00 dokumentat origjinale ose fotokopje për regjistrim si më poshtë vijon;

Kriteret e përgjithshme (dokumentacioni)

1. Të ketë kryer studimet e larta (bachelor ose mastër) diploma e instrumentit (korno) brenda ose jashtë vendit.
2. Diplomë e përfundimit të shkollës dhe listë notash të noterizuar.
3. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm.
4. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto, (veprimtaria e 2 viteve të fundit e çertifikuar, mastër class, work shop, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën artitike, experience pune për vendin që aplikon, etj). Dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar këtë kriter.
5. Të ketë njohuri minimumi të dy gjuhëve të huaja italisht dhe anglisht.

❖ Kriteret e veçanta të kualifikimit për vendin vakant Spalë Sektori Orkestra, instrumenti (Korno):

Program i detyruar:

W. A. Mozart, Koncert për korno n.4 KV495

R. Strauss, Koncert për korno n.2

Vështirësi orkestrale

1. *J.Brahms- Symphony n.1, Symphony n. 3.*

2. *V.Bellini- I Capuleti e I Montecchi.*

3. *L. van Beethoven- Fidelio (aria Leonora), Symphony n.6 (Patorale).*

4. *A.Bruckner- Symphony n.4.*

5. *P. I.Tchaikovsky- Symphony n.5 (Andante Cantabile), Symfonia n.5 (Finale, Andante Maestoso).*

6. *C.Franck- Symphony in D.*

7. *W.A.Mozart- Le Nozze di Figaro.*

8. *F.Mendelssohn- Midsummer night's dream.*

9. *G.Mahler- Symphony n.3, Symphony n.7.*

10. *M.Mussorgsky- Pictures at an exhibition.*

11. *M.Ravel- Piano concerto in G*

12. *R.Strauss- Alpensinfonie, Ein Heldenleben, Till Eulenspiegel, Don Juan.*

13. *I.Stravinsky- Fairy's kiss.*

14. *D.Shostakovich- Symphony n.5, Cello Concerto n.1.*

15. *R.Wagner- Sigfried.*

Lexim "A prima vista" në rast se komisoni do ta gjykojë të arsyeshme.

Nga literatura e repertorit skenik (opera, balet e simfoni).

Shënim:

-Vështirësitë orkestrale janë të gatshme për shkarkim në web sitin e Teatrit www.tkob.gov.al.

-Komisioni ruan të drejtën që të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.

-Nëse kandidatët nuk kanë shoqërues në piano me vete, Teatri do vendosë një shoqërues në piano në ditën e audicionit.

MIRATOI

DREJTORI i PËRGJITHSHËM

ABIGEILA VOSHTINA

